

Përmbledhje

Ky studim është mbështetur në analizën kontrastive të përshëndetjeve në shqipen dhe në italishten dhe është përshtatur me metodën përmasë-krahasuese.

Pasi kemi dhënë një paraqitje të kuadrit teorik të konceptit të mirësjelljes (kortezisë), duke marrë në konsideratë teoritë e gjysmës së dytë të shekullit XIX, që nisen nga një perspektivë pragmalinguistike, deri te ato më të rejat të dhjetëvjeçarëve të fundit, që orientohen nga një perspektivë sociologjike, kemi kaluar në analizën e mjeteve verevertët të atilla, që shërbejnë për të shprehur mirësjelljen gjuhësore. Këto mjete mund të nyjëtohen në katër vija kryesore: 1) përshëndetjet, 2) urimet, 3) mirësjellja e shprehur me anë të mjeteve leksikore (emërtimet e mirësjelljes ose apelativat e kortezisë), 4) mirësjellja e shprehur nëpërmjet mjeteve gramatikore (përemrat alokutivë). Të nisur nga konsiderata se mirësjellja është universale, përderisa të gjitha shoqëritë kanë të përbashkët sjellje, që lejojnë të mbahet harmonia ndërmjet folësve, por, në të njëjtën kohë, edhe nuk është, përderisa format e zbatimit variojnë, qoftë edhe sadopak, nga një shoqëri në tjetrën, dhe sidomos nga mbledhjet e bëra nëpërmjet intervistave të drejtuara e të mbështetura në prurje nga folës me gjuhë amtare shqipen (si edhe me shembuj të nxjerrë nga letërsia shqiptare e italiane), është synuar të analizohen se cilat janë pikat e kontaktit dhe dallimet ndërmejt dy gjuhëve kaq të ndryshme.

Kemi dashur t'i japim hapësirën e duhur edhe mirësjelljes tekstore, dhe jo vetëm asaj gojore, duke pasur si qëllim sidomos kompetencat që duhet të ketë një përkthyes në momentin që duhet të jetë në gjendje të gjejë strategjitë dhe formulat e mirësjelljes, që mishërohen në tekstin nisës në gjuhë të huaj dhe t'i përkthejë funksionet dhe objektivat e tij me strategji të tjera në gjuhën mbërritëse.

Fusha: Sociolinguistikë, etnografi e komunikimit.

Fjalë çëles: mirësjellja gjuhësore, formulat e kortezisë, përshëndetjet, urimet, etnografia e komunikimit.

Abstract

This study is based on the analysis of greetings and wishes in Albanian and Italian, which is why the contrastive method was used.

Firstly we have given a theoretical outline to the concept of *politeness* beginning from the second half of 20th century's theories, which are based on a pragmatic perspective, until the most recent theories, which are oriented towards a sociologic perspective. We have then analysed the four main instruments through which linguistic *politeness* is expressed: 1) greetings, 2) wishes, 3) politeness expressed through lexicon (politeness epithet), 4) politeness expressed through the use of different pronouns (*tu/lei* in Italian, or *ti/ju* in Albanian). We have tried to analyse the points in common and those in which the two languages differ, starting from the consideration that politeness is universal since all societies have in common behaviours which allow speakers to live in harmony. On the other hand, this consideration is not completely true since expressions do change from one society to another. Our hypothesis is sustained by the elaboration of interviews made amongst Albanian native speakers (examples are also taken from the literatures of both languages).

We have analysed politeness in written texts, not only in verbal exchanges, giving particular attention to the competence that a translator should have when recognising strategies and politeness formulas used in a foreign language text that he/she will need to translate into his/her own language using other strategies.

Field: sociolinguistics, communication ethnography.

Keys words: linguistic politeness, politeness formulas, greetings, wishes, communication ethnography.